



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



ZYRA PËR REGJISTRIMIN, CERTIFIKIMIN DHE KONTROLLIN FINANCIAR TË SUBJEKTEVE POLITIKE (Zyra) NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ) sipas autorizimeve të dhëna me paragrafin 1 të nenit 21 dhe në përputhje me nënparagrafin 4, paragrafi 6 i nenit 21 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike (LFSP), me datën 12.07.2024, merr këtë:

VENDIM

Për shqiptimin e gjobës për subjektin politik PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS

- I. Subjektit politik PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS, i shqiptohet gjoba në vlerë pesë mijë (5,000) euro për shkeljen sipas nënparagrafit 4, paragrafi 6 i nenit 21 të LFSP.
- II. Subjekti politik PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS, obligohet që brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të këtij vendimi, të paguaj shumën e gjobës së shqiptuar sipas pikës I të këtij vendimi dhe të dorëzojë në Zyrës një kopje të fletëpagesës së gjobës së paguar.
- III. Subjekti politik obligohet që në pasqyrat financiare për vitin 2024, të cilat dorëzohen jo më vonë se data 01.03.2025, t'i paraqes dëshmitë për shfrytëzimin e zyrave në komunat e Republikës së Kosovës.
- IV. Nëse subjekti politik PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS, nuk paguan gjobën brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit të Zyrës, subjektit politik nuk i transferohen mjetet financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politik në shumë e gjobës së shqiptuar.
- V. Vendimet e Zyrës për shqiptimin e gjobave hyjnë në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme.

Arsyetim

Subjekti politike PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS, është subjekt politik i regjistruar sipas legjislacionit në fuqi nga data 21.08.2000.

Sipas nenit 24 të Statutit të partisë politike PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS, dega është forma më e lartë e organizimit në nivel lokal. Ndërsa, në paragrafin 2 të nenit 24 të statutit “në secilën komunë, ku subjekti politik ka anëtarësi ekziston një degë dhe se organ kompetent për themelimin apo shuarjen e një dege është kryesia e subjektit politik”.

Sipas paragrafit 1 të nenit 29 të Statutit të partisë politike PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS, kryesitë e degëve çdo tre (3) muaj i dërgojnë raport me shkrim, kryesisë së subjektit politik, ku përfshihen edhe të hyrat dhe shpenzimet për degën përkatëse.

Subjekti politik ka tridhjetë e nëntë (39) zyrë/degë nëpër komnat e Republikës së Kosovës, ku për vetëm dy të tilla ka të deklaruar shpenzimet e qerasë. Ndërsa, për të tjerat, në mungesë të dokumentacionit mbështetës, auditori e kishte të pamundur të verifikojë vlerën e shpenzimeve të sakta të qerasë që do duhej të prezantonte dhe nëse këto do të duhej të prezantoheshin në kategorinë e të hyrave nga kontributet në natyrë. Subjekti politik në pasqyrat financiare të vitit 2023, ka prezantuar kontratën për qiranë për zyrë në komunën e Deçanit dhe kontratën për selinë qendrore në Prishtinë.

Sipas nënparagrafit 1, të paragrafit 2 të nenit 15 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, subjekti politik është i obliguar të dorëzoj raportin vjetor financiar, i cili përmban bilancin e gjendjes, duke përfshirë të gjitha degët e saj në ditët e para dhe të fundit të periudhës së përfshirë në raport. Sipas nënparagrafit 2, të paragrafit 2 të nenit 15 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, raporti duhet të përmbajë pasqyrën e fitimit dhe të humbjeve, e cila tregon të hyrat dhe shpenzimet e partisë, duke përfshirë të gjitha degët e saj gjatë periudhës së përfshirë në raport.

Për tridhjetë e shtatë (37) zyra/ degë nëpër komuna të Republikës së Kosovës, subjekti politik nuk ka ofruar asnjë dëshmi për shfrytëzimin e tyre. Sipas deklarimit nga formularët e azhurnimit vjetor, i dorëzuar 30.01.2024, që mban numrin e protokollit të Zyrës 37/ 30.01.2024, subjekti politik ka deklaruar zyrat/ degët në komnat: Glllogoc, Gjakovë, Dragash, Istog, Kaçanik, Klinë, Gjilan, Fushë Kosovë, Kamenicë, Mitrovicë, Lipjan, Obiliq, Kastriot, Rahovec, Pejë, Podujevë, Skenderaj, Shtime, Shtërpçë, Suharekë, Ferizaj, Viti, Vushtrri, Malishevë, Hani i Elezit, Junik, Prizren, Zveçan, Kllokot, Graçanicë, Mamushë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq.

Nisur nga këto fakte, Zyra e kishte të pamundur të vlerësonte saktë shumën e shpenzimeve apo kontributeve në natyrë të cilat nuk janë deklaruar nga subjekti politik.

Subjekti politik PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS, obligohet që pagesën e gjobës sipas pikës I të këtij vendimi, ta kryejë brenda tridhjetë (30) pas pranimit të vendimit për shqiptimin e gjobës përmes komunikimit zyrtar elektronik. Pagesa e gjobës duhet të dëshmohet përmes dorëzimit të kopjes së fletëpagesës në Zyrë. Në rast të dështimit të pagesës së gjobës brenda afatit të dhënë si në pikën II të këtij vendimi, subjektit politik nuk i transferohen mjetet financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike në shumë e gjobës së shqiptuar.

Nga sa u tha më lartë, Zyra vendos për shqiptimin e gjobës në vlerë prej pesë mijë (5,000) euro, sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Prishtinë, 12.07.2024

Drejtori i Zyrës


Besnik Buzhala

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të subjektit politik PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS.
- Përfaqësuesit të autorizuar financiar të subjektit politik PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS.

Këshilla juridike: Subjekti politik mund të inicojë padi kundër vendimit të Zyrës për shqiptimin e gjobave, pranë gjykatës kompetente të shkallës së parë, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, pas njoftimit për vendimin. Inicimi i padisë nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.